Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA
KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
Nr.Br.No. 01 / 32
DAT.DT. 29.01.2021
PRISHTINË

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe nenit 27 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, në mbledhjen e mbajtur me datë 26 janar 2021, miraton këtë:

RREGULLORE NR. 01/2021 PËR VLERËSIMIN E PERFORMANCËS SË GJYQTARËVE

KREU I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Kjo rregullore përcakton kriteret dhe rregullat lidhur me vlerësimin e performancës së gjyqtarëve, si dhe për përcaktimin e përbërjes dhe mandatit të Komisionit për Vlerësim të Performancës.

2. Vlerësimi i performancës përbën bazë për ngritje apo ulje në detyrë, ri-emërimin e gjyqtarit dhe për inicimin e procedurës për shkarkim.

3. Përmes vlerësimit të performancës synohet ngritja e efikasitetit të sistemit gjyqësor në përgjithësi dhe gjyqtarëve në veçanti, duke krijuar mekanizma që sigurojnë një sistem transparent dhe llogaridhënës.

4. Kjo Rregullore zbatohet për të gjithë gjyqtarët e gjykatave të Kosovës, përveç kryetarëve të gjykatave, gjyqtarëve të cilët për më tepër se tri vitet e fundit kanë mbajtur pozita udhëheqëse dhe anëtarëve të KGJK-së për kohen sa kanë shërbyer me orar të plotë në Këshill.

Neni 2
Përkufizimet

1. Termat dhe shkurtesat e përdorura në këtë rregullore kanë këtë kuptim:

1.1. **Komisioni** – nënkupton Komisionin për Vlerësim të Performancës, përgjegjës për vlerësimin e performancës së gjyqtarëve

1.2. **Ligj** – nënkupton Ligjin Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës

1.3. **Këshilli** – nënkupton Këshillin Gjyqësor të Kosovës

1.4. **SKGJK** – nënkupton Sekretariatin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës

1.5. **NJIGJ** – nënkupton Njësinë për Inspektim Gjyqësor

1.6. **Gjyqtari vlerësues** - nënkupton një (1) anëtar të Komisionit Vlerësues, i cili bën vlerësimin e gjyqtarëve sipas planit vjetor të punës

2. Shprehjet e përdorura në njëjës e kanë të njëjtin kuptim edhe në shumës. Fjalët e përdorura në një gjini përfshijnë edhe gjininë tjetër.

Neni 3
Parimet e vlerësimit

1. Vlerësimi i gjyqtarëve bëhet në pajtim me parimin e ligjshmërisë, objektivitetit, transparencës dhe barazisë, me qëllim që të garantohen mundësi të barabarta dhe të drejta për zhvillim të karrierës së gjyqtarit.

2. Vlerësimi nuk ka për qëllim që të ndërhyjë në pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqtarit.

3. Përveç nëse nuk parashihet ndryshe me ligj ose rregullore, të gjitha të dhënat dhe informatat e mbledhura gjatë procesit vlerësues të performancës janë konfidenciale dhe nuk zbulohen gjatë fazës së parë të vlerësimit. Zbulimi i çfarëdo informacionit që cenon konfidencialitetin e procesit vlerësues përbën shkelje disiplinore dhe do të trajtohet sipas legjiclacionit në fuqi.

Neni 4
Periudha e vlerësimit

1. Gjyqtarët me mandat fillestar vlerësohen 2 (dy) herë përgjatë këtij mandati, një herë pas trajnimit fillestar dhe njëherë para skadimit të mandatit fillestar me qëllim të riemërimit.

2. Gjyqtarët me mandat të përhershëm vlerësohen çdo 3 (tre) vjet.

KREU II
KOMISIONI PËR VLERËSIMIN E PERFORMANCËS

Neni 5
Përbërja dhe mandati i Komisionit

1. Komisioni përbëhet prej trembëdhjetë (13) anëtarëve-gjyqtarë, duke përfshirë kryetarin e Komisionit. Komisioni duhet të ketë gjithashtu edhe 3 (tre) anëtarë rezervë. Përbërja e Komisionit duhet të pasqyroj strukturën etnike dhe gjinore të gjyqësorit.

2. Komisioni përbëhet nga gjyqtarë të të gjitha gjykatave, duke përfshirë pesë (5) gjyqtarë nga Gjykata Supreme, pesë (5) gjyqtarë nga Gjykata e Apelit dhe tre (3) gjyqtarë nga gjykatat themelore. Anëtarët rezervë zgjedhën nga 1 (një) gjyqtar nga secila instancë gjyqësore.

3. Përzgjedhja e anëtarëve të Komisionit bëhet përmes një procesi të hapur dhe konkurrues. Këshilli shpall pozitat e hapura për konkurs të brendshëm në faqen e internetit.

3. Anëtar i Komisionit mund të caktohet vetëm gjyqtari i cili:

3.1. ka së paku pesë (5) vite përvojë pune në lëmin civile, penale, ekonomike dhe administrative;

3.2. nuk i është shqiptuar masë disiplinore gjatë pesë (5) viteve të fundit, përjashtimisht masës së qortimit, apo vërejtjes jopublike me shkrim;

3.3. nuk është duke u zhvilluar procedurë hetimore për shkelje të rëndë disiplinore;

3.4. nuk shërben si kryetar i gjykatës apo anëtar i Këshillit, përveç Kryetarit të Komisionit i cili është anëtarë me mandatë të plotë në Këshill, ose nuk shërben si Kryetar apo Kryesues i ndonjë institucioni tjetër; si dhe

3.5. është vlerësuar me notën "shkëlqyeshëm" ose së paku notën "shumë mirë" në vlerësimin e fundit të performancës.

4. Këshilli formon një Komision të përbërë nga tre anëtarë nga radhët e vet Këshillit. Ky Komision do të shqyrtojë dokumentacionin e dorëzuar nga kandidatë për anëtarë dhe gjithashtu do të krijojë listën me kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e përcaktuara me këtë rregullore.

5. Komisioni përkatës do të dorëzojë listat e kandidatëve të kualifikuar për secilin kategori në Këshill, pas kësaj përzgjedhja e anëtarëve do të bëhet me short nga këto lista për secilin kategori.

6. Anëtarët e Komisionit emërohen nga Këshilli, nga radhët e gjyqtareve te cilët i plotësojnë kriteret sipas kësaj rregulloreje.

7. Mandati i anëtarëve të Komisionit është tre (3) vjeçar, pa të drejtë rizgjedhje për mandat të njëpasnjëshëm.

8. Anëtarët e Komisionit, në fillim të mandatit dhe gjatë gjithë mandatit të tyre, deklarojnë çfarëdo konflikti të interesit që mund të kenë me ndonjë gjyqtar. Mos deklarimi i konfliktit të interesit është shkelje disiplinore, e cila do të trajtohet sipas legjiclacionit në fuqi.

Neni 6
Kryetari i Komisionit dhe kompetencat

1. Kryetari i Komisionit, caktohet nga Këshilli, në parim nga radhët e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme, që janë anëtarë të Këshillit.

2. Kryetari i Komisionit ka këto kompetenca:

2.1. përgatitë planin dhe organizon punën e komisionit,

2.2. thërret dhe udhëheq takimet e komisionit,

2.3. mbikëqyrë rregullsinë e procesit të vlerësimit të performancës,

2.4. vendos lidhur me përjashtimin e vlerësuesve sipas kërkesës,

2.5. përgatitë raporte dhe jep rekomandime lidhur me punën e komisionit,

2.6. përfaqëson komisionin në takimet e ndryshme,

2.7. nënshkruan raportet përfundimtare për vlerësimin, vendimet nga seanca plenare, si dhe kryen punë tjera për funksionimin e këtij komisioni.

3. Kryetari i Komisionit nuk mund të caktohet si gjyqtar vlerësues.

Neni 7
Detyrat e gjyqtarit vlerësues të Komisionit

1. Gjyqtari vlerësues bën vlerësimin e gjyqtarëve për të cilët është ngarkuar nga kryetari i Komisionit duke respektuar parimin e profesionalizmit, objektivitetin, konfidencialitetin dhe anonimitetit të procedurës.

2. Pasi që bëhet ndarja e gjyqtarëve të cilët do jenë subjekt vlerësimi, gjyqtari vlerësues i komisionit bënë organizimin e punës se tij në atë mënyrë që brenda nëntë (9) muajve ne vijim të bëjë vlerësimin e gjithë gjyqtarëve për të cilët është ngarkuar me planin vjetor të punës, përveç nëse parashihet ndryshe me këtë rregullore.

3. Gjyqtari vlerësues e harton dhe e nënshkruan raportin e vlerësimit.

Neni 8
Mbështetje administrative

1. NJIGJ dhe SKGJK i ofrojnë mbështetje administrative komisionit për vlerësimin e performancës së gjyqtarëve.

2. NJIGJ dhe SKGJK cakton sekretarin dhe zyrtarët tjerë në mbështetje të komisionit nga radhët e zyrtarëve.

3. Sekretari i Komisionit siguron:

3.1. realizimin e tërheqjes së shortit me metodën "random" për përzgjedhjen e gjyqtarëve për vlerësim, në bashkëpunim me kryetarin e Komisionit dhe zyrtarin e Departamentit të statistikave të SKGJK-së,

3.2. grumbullimin e informatave dhe dokumenteve nga Departamenti i Statistikave të SKGJK-së dhe Zyra Qendrore për Menaxhimin e Lëndëve të gjykatës përkatëse, si dhe të

dhëna të tjera të parapara në këtë rregullore, për qëllim përzgjedhjes së vendimeve gjyqësore, monitorimit të seancave gjyqësore dhe trajnimeve eventuale,

3.3. anonimizimin e të gjitha informatave dhe dokumenteve që shërbejnë për vlerësimin e gjyqtarëve, në fazat siç janë përcaktuara me këtë rregullore, dhe ruajtjen e konfidencialitetit të procesit,

3.4. njoftimin e kryetarit të gjykatës përkatëse së gjyqtarit i cili është subjekt i vlerësimit,

3.5. parashtrimin e kërkesave ndaj shërbimeve të ndryshme për dhënien e informacioneve të nevojshme për vlerësim,

3.6. në bashkëpunim me kryetarin e Komisionit, organizon dhe asiston në takimet e Komisionit,

3.7. punët e tjera të cilat i përcakton kryetari i komisionit.

Neni 9
Plani dhe organizimi vjetor i punës së Komisionit

1. Në çdo fillim të vitit, Komisioni për vlerësim miraton planin vjetor të punës përmes së cilit bëhet organizimi dhe ndarja e punëve ndërmjet anëtarëve-gjyqtarë vlerësues të Komisionit.

2. Pas përzgjedhjes me short të 1/3 të gjyqtarëve nga ana e Këshillit, Kryetari i Komisionit në bashkëpunim me sekretarin dhe stafin mbështetës bëjnë ndarjen e numrit të gjyqtarëve në mënyrë proporcionale për secilin vlerësues, ashtu që ndarja e punës të siguroj objektivitet dhe evitimin potencial të konfliktit të interesit.

3. Plani vjetor i punës miratohet në fillim të vitit kalendarik, jo më vonë se në fund të muajit janar

KREU III
RREGULLAT BAZË TË VLERËSIMIT

Neni 10
Përzgjedhja me short

1. Gjyqtarët me mandat të përhershëm vlerësohen sipas radhës së përcaktuar përmes metodës së shortit.

2. Para fillimit të secilit vit kalendarik, Këshilli nga lista e përgjithshme e gjyqtarëve të radhitur sipas gjykatave në programin Excel, përmes komandës 'random', përzgjedhë 1/3 e gjyqtarëve të cilët do t'i nënshtrohen vlerësimit në vitin vijues.

3. Anëtarët e Komisionit nuk mund të vlerësohen gjatë kohës së mandatit të tyre në Komision. Të njëjtit do të vlerësohen menjëherë pas përfundimit të mandatit të tyre si anëtar të Komisionit.

4. Për Kryetarët e gjykatave dhe gjyqtarët mbikëqyrës, vlerësimi do të bëhet sipas Rregullores për Vlerësim të Kryetarëve të Gjykatave. Ndërsa, për anëtarët me orar të plotë të Këshillit, vlerësimi i performancës do të bëhet në bazë të një rregullore të veçantë.

5. Vlerësimi i gjyqtarëve, të cilët gjatë tri viteve të fundit kanë kryer funksionin e gjyqtarit për një periudhe, ndërsa në periudhën tjetër kanë kryer funksione të tjera udhëheqëse ose përfaqësuese, bëhet përpjesëtimisht për periudhën gjatë së cilës ata kanë punuar si gjyqtarë.

Neni 11
Kriteret e vlerësimit

1. Kriteret e vlerësimit të përcaktuara me nenin 27 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, janë si në vijim:

1. Aftësinë profesionale, bazuar në rezultatin e punës gjatë periudhës së vlerësimit, përfshirë pjesëmarrjen në formate organizuara të trajnimit ku është vlerësuar performanca;

2. Numrin e lëndëve të kthyera në rigjykim apo rivendosje, apo lëndëve të prishura nga gjykata më e lartë, në raport me numrin e lëndëve të kryera;

3. Aftësinë për të kryer detyrat në mënyrë të paanshme, të ndershme, me kujdes dhe me përgjegjësi, sjelljen jashtë zyrës dhe integritetin personal;

4. Njohurinë profesionale, përvojën e punës dhe performancës, përfshirë njohuritë, respektimin e të drejtave të njeriut dhe aftësinë komunikuese;

5. Kapacitetin për arsyetime ligjore dhe aftësinë ne analizimin e problemeve ligjore.

Neni 12
Treguesit matës të kritereve për vlerësim

1. Kriteri "Aftësia profesionale, bazuar në rezultatin e punës gjatë periudhës së vlerësimit, përfshirë pjesëmarrjen në forma të organizuara të trajnimit ku është vlerësuar performanca" matet përmes treguesve si në vijim:

1.1. Menaxhimi efikas i lëndëve,

1.2. Efikasiteti i zgjidhjes së lëndëve të vjetra në shqyrtim,

1.3. Shkalla e lëndëve të kryera në raport me lëndët e pranuara,

1.4. Marrja, hartimi dhe dorëzimi i vendimeve brenda afateve kohore,

1.5. Respektimi i normës gjyqësore,

1.6. Pjesëmarrja në trajnime gjyqësore,

1.7. Vullneti për të zgjidhur lëndë komplekse,

1.8. Raporti ndërmjet vendimeve meritore dhe vendimeve procedurale,

1.9. Përdorimi i SMIL (nëse është në përdorim),

1.10. Vlerësimi i shqyrtimit të lëndëve brenda afateve kohore.

2. Kriteri "Numri i lëndëve të kthyera në rigjykim apo rivendosje, apo lëndëve të prishura nga gjykata më e lartë" matet përmes treguesve si në vijim:

2.1. Numri i vendimeve të kthyera në procedurë ankimore, për shkak te shkeljeve procedurale,

2.2. Numri i vendimeve të kthyera në procedurë ankimore për shkak të vërtetimit të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike.

3. Kriteri "Aftësia për të kryer detyrat në mënyrë të paanshme, të ndershme, me kujdes dhe me përgjegjësi, sjellja jashtë zyrës dhe integriteti personal" matet përmes treguesve si në vijim:

3.1. Dorëzimi apo vënia ne dispozicion e te gjitha vendimeve tek personat përgjegjës për publikimin e vendimeve,

3.2. Bashkëpunimi i gjyqtarit me zyrtarët përgjegjës të administratës gjyqësore në lidhje me mirëmbajtjen e dosjes gjyqësore,

3.3. Sjellja profesionale e gjyqtarit, mos dhënia e informatave të rëndësishme dhe konfidenciale, përdorimi në mënyrë dinjitoze i rrjeteve sociale duke e ruajtur integritetin profesional dhe gjyqësor, shmangia e komunikimit ex-parte me palët ne procedurë dhe qëndrimet apolitike,

3.4. E kaluara disiplinore e gjyqtarit.

4. Kriteri "Njohuria profesionale, përvoja e punës dhe performanca, përfshirë njohuritë, respektimin e të drejtave të njeriut dhe aftësia komunikuese" matet përmes treguesve si në vijim:

4.1. Njohuria e ligjeve te aplikueshme,

4.2. Përvoja e punës,

4.3. Zbatim i standardeve juridike ndërkombëtare,

4.4. Komunikim i qartë dhe logjik.

5. Kriteri "Kapaciteti për arsyetime ligjore dhe aftësia në analizimin e problemeve ligjore" matet përmes treguesve si në vijim:

5.1. Cilësia dhe arsyetimi i vendimit,

5.2. Aftësia analitike e gjyqtarit.

6. Kriteret dhe nën-kriteret e përcaktuara në këtë Rregullore, në parim vlejnë për të gjithë gjyqtarët, përveç në ato raste kur kriteret apo nën-kriteret e caktuara nuk janë të aplikueshme për Gjyqtarët e Gjykatës se Apelit dhe asaj Supreme.

Neni 13
Burimet e Informacionit

1. Burimet e informacionit që përdoren për vlerësimin e gjyqtarëve janë:

1.1. vendimet e zgjedhura siç është paraparë në nenin 21 të kësaj rregullore,

1.2. dosja personale e gjyqtarit,

1.3. raporti i kryetarit të gjykatës, të konfirmuar nga udhëheqësi i departamentit/divizionit përkatës,

1.4. statistikat,

1.5. raporti i anëtarit vlerësues i Komisionit nga monitorimi i seancave dhe raporti i aktiviteteve trajnuese,

1.6. vendimet disiplinore,

1.7. çfarëdo veprimi apo dokumenti tjetër zyrtar që përmban informacione objektive dhe relevante lidhur me aktivitetet profesionale dhe sjelljen personale që ndikon në aktivitetet profesionale të gjyqtarit.

2. Burimet e informacionit të parapara në këtë nen zbatohen përshtatshmërisht për vlerësimin e gjyqtarëve me mandat fillestar, dhe kufizohen vetëm në indikatorë të matshëm që janë të zbatueshëm për gjyqtarët e Gjykatës Supreme.

3. Të dhënat për të dëshmuar performancën e gjyqtarit nuk mund të jenë më të vjetra se tre (3) vite pune si gjyqtar, nga viti kur bëhet vlerësimi i performancës.

Neni 14
Shkallët e vlerësimit

1. Gjyqtarët vlerësohen sipas shkallëve në vijim, prej 0 deri në 89 pikë dhe atë:

1.1. Prej 0 deri në 35 pikë vlerësohet "dobët",

1.2. Prej 36 deri në 51 pikë vlerësohet "mjaftueshëm",

1.3. Prej 52 deri në 67 pikë vlerësohet "mirë",

1.4. Prej 68 deri në 82 pikë vlerësohet "shumë mirë",

1.5. Prej 83 deri në 89 pikë vlerësohet "shkëlqyeshëm".

2. Vetëm gjyqtarët që vlerësohen me vlerësimin "shkëlqyeshëm" do të konsiderohen për ngritje në detyrë, në rast të pozitave të lira në Gjykatën e Apelit dhe/ose Supreme. Në rast se vlerësimi rezulton se nuk ka mjaftueshëm gjyqtarë të ranguar sipas pikëve me vlerësim "shkëlqyeshëm", Këshilli merr në konsiderim gjyqtarët e ranguar sipas pikëve me vlerësimin "shumë mirë".

3. Komisioni për vlerësim do të përpilojë një Udhëzues për vlerësimin e gjyqtarëve për secilin indikator i cili do të bëhet publik për gjyqtarët para së të fillojë procesi i vlerësimit.

KREU IV
VLERËSIMI I GJYQTARËVE ME MANDAT FILLESTAR

Neni 15
Kriteret e vlerësimit dhe burimet e informacionit

1. Përgjatë vijimit të trajnimit fillestar, gjyqtarët me mandat fillestar vlerësohen në fund të trajnimit fillestar 12 mujor, dhe vlerësimi i tyre bëhet duke marrë për bazë njohuritë e fituara përgjatë trajnimit në pjesën teorike dhe atë praktike.

2. Vlerësimi i gjyqtarëve me mandat fillestar bëhet nga Komisioni duke marrë për bazë raportet e trajnuesve dhe mentorëve dhe bëhet përshtatshmërisht sipas kritereve dhe parimeve të vlerësimit për gjyqtarët më mandat të përhershëm, aq sa ato janë të aplikueshme.

3. Komisioni përpilon raport uniform mbi bazën e raportit nga trajnuesi (pjesa teorike) dhe mentori (pjesa praktike) e gjyqtarëve me mandat fillestar.

4. Nëse gjyqtari me mandat fillestar dështon të përfundoj trajnimin ne mënyrë adekuate ashtu siç është vlerësuar sipas raportit te mentorit dhe trajnuesit, Komisioni mund të rekomandoj vazhdimin e trajnimit fillestar edhe për më së shumti tre (3) muaj.

5. Nëse gjyqtari me mandat fillestar pranon një raport negativ nga mentori dhe trajnuesi në fund te trajnimit fillestar dhe si rrjedhojë merr vlerësimin negativ edhe nga komisioni, i njëjti propozohet për shkarkim.

Neni 16
Vlerësimi përfundimtar i trajnimit fillestar

Pas pranimit të raporteve nga trajnuesi dhe mentori përfshirë edhe komentet e gjyqtarit, Komisioni për Vlerësimin e Performancës bazuar në këto raporte vlerëson performancën e gjyqtarit.

Neni 17
Vlerësimi i gjyqtarëve për qëllim të ri-emërimit

1. Sekretari i Komisionit, së paku gjashtë (6) muaj para skadimit të mandatit fillestar, njofton Kryetarin e Komisionit dhe gjyqtarin në lidhje me fillimin e procedurës për vlerësimin e performancës se tij për qëllim të ri-emërimit.

2. Jo më vonë se tre (3) muaj para skadimit të mandatit fillestar, Komisioni bën vlerësimin e dytë të gjyqtarëve.

3. Kriteret e përcaktuara për vlerësimin e gjyqtarëve me mandat të përhershëm sipas kësaj Rregulloreje zbatohen përshtatshmërisht për këtë vlerësim.

4. KGJK merr vendim mbi vlerësimin e gjyqtarit brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh pas pranimit të raportit nga Komisioni për vlerësimin e performancës së gjyqtarëve.

5. KGJK, ia dërgon Presidentit te Republikës se Kosovës, emrat e gjyqtarëve te propozuar për ri-emërim te përhershëm, më së voni pesëmbëdhjetë (15) ditë para skadimit të mandatit fillestar.

KREU V
VLERËSIMI I GJYQTARËVE ME MANDAT TË PËRHERSHËM

Neni 18
Anonimiteti i procedurës së vlerësimit

Çdo i punësuar i Këshillit, Sekretariatit, NJIGJ-it apo gjykatave i përfshirë në procesin e vlerësimit të performancës obligohet të ruaj dhe siguroj anonimitetin e procedurës në fazat e parapara me rregullore. Mos respektimi i këtij parimi nga të punësuarit, përmes të cilit cenohet anonimiteti i procesit vlerësues përbënë shkelje të rëndë disiplinore.

Neni 19
Vlerësimi i gjyqtarëve të përhershëm për qëllime të ngritjes në detyrë

Në rastet kur një gjyqtar kandidon për ngritje në detyrë, si bazë për vlerësimin e tij do të merret vlerësimi i performancës i cili është bërë brenda tri viteve të fundit, për punën e tij si gjyqtar.

Neni 20
Ndarja e listës së gjyqtarëve për vlerësim

1. Pas zgjedhjes së gjyqtareve nga lista random, stafi mbështetës renditë numrin e gjyqtarëve për vlerësim dhe pastron listën nga gjyqtarët me mandat fillestar.

2. Lista përfundimtare e gjyqtarëve për vlerësim u ndahet anëtarëve të Komisionit nga Kryetari i Komisionit sipas rregullave si vijon:

2.1. anëtarëve të Komisionit nga radhët e Gjykatës Supreme u ndahen për vlerësim gjyqtarët e gjitha niveleve,

2.2. anëtarëve të Komisionit nga radhët e Gjykatës së Apelit dhe nga radhët e gjykatave themelore u ndahen për vlerësim gjyqtarët e gjykatave themelore.

Neni 21
Rregullat për zgjedhjen e rastësishme të vendimeve

1. Zyra e Statistikave të SKGJK-së, siguron ndarjen e të dhënave për vendimet gjyqësore vetëm në vendime meritore dhe bën përzgjedhjen e rastësishme të gjashtë (6) vendimeve gjyqësore, por në asnjë rast më pak se dy (2) vendimeve për secilin vit të vlerësimit.

2. Sekretari i Komisionit do të kërkojë nga Zyra Qendrore për Menaxhimin e Lëndëve, kopjet e vendimeve gjyqësore që korrespondojnë me numrin për zgjedhjen e rastësishme të vendimeve gjyqësore.

Neni 22
Faza përgatitore

1. Para fillimit të fazës së parë të vlerësimit, sekretari dhe stafi mbështetës i Komisionit, nën mbikëqyrjen e kryetarit të Komisionit, udhëheqin fazën përgatitore në të cilën sigurohet që:

1.1. emrat e gjyqtarëve në vlerësim të zëvendësohen me një numër unik tre shifror,

1.2. të përzgjidhen vendimet gjyqësore për vlerësim në përputhje me këtë rregullore,

1.3. të mblidhet i gjithë informacioni dhe të dhënat statistikore të nevojshme gjatë fazës së parë të vlerësimit të gjyqtarëve,

1.4. të anonimizohen të gjitha informacionet, vendimet dhe të dhënat e parapara në këtë nen, para se ato të i ndahen gjyqtarit vlerësues.

2. Pas mbledhjes dhe anonimizimit të informacionit, vendimeve dhe të dhënave të tjera, sekretari, në bashkëpunim me kryetarin e Komisionit ndajnë listën e gjyqtarëve në mënyrë proporcionale për secilin vlerësues në pajtim me këtë rregullore, dhe sigurojnë evitimin e çfarëdo konfliktit të interesit potencial.

Neni 23
Faza e parë e vlerësimit

1. Faza e parë është vlerësimi anonim i gjyqtarit, në të cilën gjyqtarët vlerësues vlerësojnë kriteret 1, 2, dhe 5, të nenit 11, si dhe treguesit matës 3.4, 4.1, 4.2, 4.3, siç parashihen në nenin 12 të kësaj rregullore.

2. Pas pranimit të të gjithë dokumentacionit të nevojshëm për vlerësim dhe listës së gjyqtarëve që i janë ndarë për vlerësim, gjyqtari vlerësues fillon vlerësimin e atyre gjyqtarëve.

3. Gjyqtari vlerësues përfundon vlerësimin si në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni, mbyllë vlerësimin për këto kritere dhe e nënshkruan raportin e vlerësimit të paraqitur në Shtojcën 2 të kësaj Rregullore.

4. Raporti i vlerësimit duhet të përmbajë arsyetimin e gjyqtarit vlerësues për secilin kriter dhe tregues matës.

5. Raportin e nënshkruar së bashku me dokumentet përkatëse të përdorura për vlerësim, gjyqtari vlerësues ia dorëzon kryetarit të Komisionit, i cili nuk mund të ndryshohet, përveç në rastet kur Komisioni vendos në procedurë të ankesës

Neni 24
Faza e dytë e vlerësimit

1. Faza e dytë është fazë e hapur, ku identiteti i gjyqtarit të vlerësuar bëhet i ditur për gjyqtarin vlerësues dhe përfshin vlerësimin sipas nenit 12 te kësaj rregullore, për treguesit matës 3.1, 3.2, 3.3 dhe 4.4.

2. Pas dorëzimit të raportit, sekretari i Komisionit njofton gjyqtarin vlerësues për identitetin e gjyqtarit i cili është subjekt i vlerësimit, në mënyrë që të vazhdojë me vlerësimin e kritereve të mbetura.

3. Sekretari, nën mbikëqyrjen e kryetarit të Komisionit, njofton kryetarët e gjykatave për inicimin e procedurës së vlerësimit për gjyqtarin përkatës dhe kërkon raportin nga kryetarët sipas nenit 12 te kësaj rregullore, për treguesit matës 3.1, 3.2 dhe 3.3.

4. Sekretari i Komisionit siguron informacionin e nevojshëm për monitorimin e seancave gjyqësore të gjyqtarit në vlerësim dhe për të njëjtën e njofton gjyqtarin vlerësues dhe gjyqtarin në vlerësim.

5. Pas vlerësimit, gjyqtari vlerësues ia dorëzon Kryetarit të Komisionit raportin e vlerësimit të nënshkruar të paraqitur si në Shtojcën 3 të kësaj Rregullore së bashku me dokumentet përkatëse të përdorura për vlerësim.

6. Raporti i vlerësimit duhet të përmbajë arsyetimin e gjyqtarit vlerësues për secilin kriter dhe tregues matës.

Neni 25
Raporti i kryetarit të gjykatës

1. Kryetari i gjykatës, ia dorëzon sekretarit të Komisionit raportin për secilin gjyqtar në gjykatën përkatëse, brenda (15) pesëmbëdhjetë ditëve nga marrja e njoftimit.

2. Kryetari i gjykatës ne konsultim me udhëheqësin e departamentit apo divizionit përkatës përgatit raport i cili duhet të përfshijë informata që shërbejnë për vlerësimin e kritereve në nenin 12, paragrafët 3.1, 3.2 dhe 3.3 të kësaj Rregullore.

3. Raporti i kryetarit duhet të përmbajë arsyetimin për secilin kriter dhe tregues matës. Gjyqtari vlerësues apo Komisioni, ka të drejtë të kërkoj informacione plotësuese apo sqarime nga kryetari i gjykatës, i cili brenda 3 (tre) ditëve duhet të veproj sipas kësaj kërkese.

4. Forma dhe përmbajtja e Raportit përcaktohet në Shtojcën 4 të kësaj Rregullore. Dokumentet përkatëse të përdorura për vlerësim duhet të bashkëngjiten.

Neni 26
Kundërshtimi i gjyqtarit ndaj raportit të vlerësimit të gjyqtarit vlerësues

1. Raporti i gjyqtarit vlerësues i dorëzohet gjyqtarit që është subjekt i vlerësimit. Ai ka të drejte të paraqesë kundërshtim jo më vonë se shtatë (7) ditë nga data e pranimit.

2. Raporti i vlerësimit për secilin gjyqtar së bashku me komentet apo vërejtjet eventuale të gjyqtarit i dorëzohet kryetarit të Komisionit me të gjitha shkresat dhe të dhënat e mbledhura gjatë vlerësimit jo më vonë se data 15 nëntor të vitit kalendarik.

3. Për kundërshtimin e gjyqtarit subjekt të vlerësimit vendos Komisioni në seancë plenare.

Neni 27
Seanca plenare e Komisionit

1. Pas pranimit të raporteve nga secili vlerësues, kryetari thërret dhe udhëheq seancat plenare të Komisionit ku diskutohet mbi secilin raport veç e veç. Në mungesë të kryetarit të Komisionit, seanca udhëhiqet nga anëtari më i vjetër i Komisionit.

2. Gjyqtari vlerësues është përgjegjës për të raportuar përkitazi me raportet për gjyqtarët për të cilët ka qenë përgjegjës për vlerësimin.

3. Si rregull, fillimisht diskutohet vetëm për ato raporte që nuk ka vërejtje apo komente nga ana e gjyqtarit.

4. Në raste kur ka vërejtje apo komente, në seancë plenare ftohet gjyqtari në fjalë për të paraqitur argumentet e tij përkitazi me raportin. Komisioni vendosë me shumicë votash në lidhje me kundërshtimet eventuale.

5. Komisioni, ka të drejtë që në seancë plenare, me shumicën e votave të anëtarëve, ta ndryshoj dhe plotësoj raportin e gjyqtarit vlerësues, nëse vlerëson se nuk është në përputhje me treguesit matës dhe kriteret e përcaktuara me këtë rregullore, duke dhënë arsyetimin përkatës.

6. Komisioni bazuar në raportet e gjyqtarit vlerësues të komisionit dhe vendimit përfundimtar të Komisionit përgatit listën në bazë të notave të marra përgjatë vlerësimit të të gjithë gjyqtarëve, listë e cila do te shërbej si bazë për Këshillin për avancim apo ulje në detyrë.

7. Seancat plenare të Komisionit janë të mbyllura dhe zhvillohen nëse së paku nëntë (9) anëtarë janë prezent.

8. Komisioni për vlerësimin e performancës së gjyqtarëve vendos sipas rregullit me shumicë të thjesht të votave, të anëtarëve të pranishëm. Në rast të rekomandimit për shkarkim të gjyqtarit, Komisioni vendos me 2/3 e të gjithë anëtarëve të pranishëm të Komisionit.

Neni 28
Ankesa ndaj vendimit të Komisionit

1. Pas seancës plenare, çdo gjyqtar i vlerësuar njoftohet me rezultatet e vlerësimit të raportit të Komisionit dhe në rast të mospajtimit, në afat prej 7 (shtatë) ditësh, nga dita e njoftimit, mund të paraqesë ankesë në Këshill.

2. Pas pranimit të ankesave, Sekretari i Komisionit përgatitë dosjen e nevojshme për secilën ankesë dhe i prezanton në mbledhjen e Këshillit.

3. Këshilli mund të hedh poshtë, refuzojë ose miratojë ankesën.

4. Në rastet kur Këshilli e miraton ankesën, vlerësimi mund të ndryshohet nga Këshilli ose mund t'i rekomandojë Komisionit ri-vlerësimin e pjesëve të caktuara. Rekomandimet e Këshillit janë obligative për Komisionin.

5. Gjyqtari i cili i nënshtrohet rivlerësimit mund të paraqesë kundërshtim për të cilin vendos Këshilli.

Neni 29
Raporti i Komisionit

1. Komisioni i dërgon Këshillit raportin përmbledhës për vlerësimin e secilit gjyqtar bazuar në Shtojcën 5 si dhe ranglistën e gjyqtarëve sipas vlerësimit të kryer e cilat nuk do të jetë publike.

2. Këshilli mund t'i kërkojë informata shtesë Komisionit përkitazi me ranglistën por nuk mund të ndryshoje atë, përpos në rastet kur Këshilli vendos mbi mos pajtimet me shkrim.

3. Në rastet kur vlerësimi i gjyqtarit rezulton me shkallën "mirë", atëherë Komisioni vlerësues rekomandon masa shtesë për përmirësimin e punës së gjyqtarëve. Në këto raste vlerësimi pasues bëhet siç përcaktohet me ligj.

4. Komisioni rekomandon uljen në detyrë dhe masa shtesë në rastet kur gjyqtari vlerësohet me vlerësimin "mjaftueshëm". Në raste të tilla, gjyqtari vlerësohet edhe një herë, jo më vonë se një (1) vit nga vlerësimi i fundit, dhe nëse edhe me këtë vlerësim nuk ka performancë më të mirë dhe vijon të vlerësohet me shkallën "mjaftueshëm" i rekomandohet Këshillit shkarkimi i gjyqtarit.

5. Komisioni i rekomandon Këshillit inicimin e procedurës për shkarkimin e gjyqtarit në rast se gjyqtari merr vlerësimin "dobët".

6. Për qëllim të paragrafit 3 dhe 4 të këtij neni, masa shtesë nënkuptojnë, por që nuk kufizohen në, vijimin e trajnimeve obligative për menaxhimin e rasteve, përpilimin e vendimeve gjyqësore dhe kodin e etikës.

Neni 30
Ankesa ndaj vendimit të Këshillit

1. Gjyqtari ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në Gjykatën Supreme të Kosovës, ndaj vendimeve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, lidhur me vlerësimin e performancës së gjyqtarëve, që për pasojë kanë uljen në detyrë të gjyqtarëve.

2. Gjykata Supreme, brenda nëntëdhjetë (90) ditëve nga koha e pranimit të ankesës, duhet të vendosë sipas meritës.

Neni 31
Transparenca

Raporti në lidhje me vlerësimin e performancës se gjyqtareve bëhet publik deri ne masën sa nuk rrezikohet konfidencialiteti i identitetit te gjyqtarëve. Këto të dhëna bëhen pjesë e raportit vjetor të KGJK-së.

KREU VI
DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 32
Udhëzuesi dhe Shtojcat

1. Këshilli dizajnon, ndryshon, plotëson dhe aprovon Udhëzuesin për Vlerësimin e Performancës, dhe gjitha shtojcave të listuara në këtë rregullore, përveç ato të parapara në nenin 15, të kësaj rregullore. Këto shtojca bëhen pjesë integrale e kësaj rregullore pas miratimit.

2. Këshilli duhet të miratoj Udhëzuesin për Vlerësimin e Performancës dhe shtojcat brenda tridhjetë (30) ditëve nga aprovimi i kësaj rregullore dhe të njëjtat do të publikohen pas miratimit.

Neni 33
Mandati fillestar i anëtarëve të Komisionit për Vlerësimin e Gjyqtarëve

1. Përjashtimisht nga përcaktimi në nenin 5 të kësaj Rregullore, për herën e parë, pas miratimit të kësaj rregullore, mandati i anëtarëve të Komisionit për Vlerësimin e Performancës së Gjyqtarëve do të jetë i shkallëzuar, dhe atë si vijon:

a. 1/3 e gjithë anëtarëve të kenë mandat 2 vjeçar, dhe
b. 2/3 e gjithë anëtarëve të kenë mandat 3 vjeçar.

2. Përzgjedhja e anëtarëve me mandate të ndryshme do të bëhet me short.

3. Pas herës së parë të përzgjedhjes së anëtarëve me mandate të ndryshme, të gjithë anëtarët do të kenë mandat të rregullt tre (3) vjeçar.

4. Me formimin e Komisionit të ri në bazë të kësaj rregullore, shpërbëhet Komisioni aktual.

Neni 34
Shfuqizimet

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohen Rregulloret e Këshillit:

- Rregullorja Nr.11/2016 për Vlerësimin e Performancës së Gjyqtarëve,
- Rregullorja Nr.01/2019, për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores Nr.11/2016 për Vlerësimin e Performancës së Gjyqtareve,

- Rregullorja Nr.10/2017 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr.11/2016 për Vlerësimin e Performancës së Gjyqtarëve, dhe
- Rregullorja Nr.02/2017 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores Nr.11/2016 për Vlerësimin e performancës së gjyqtarëve,
- Udhëzuesin për Vlerësimin e Performancës dhe shtojcat e tjera.

Neni 35
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Këshilli.

Skender Çoçaj,

Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Prishtinë, më: 29.01.2021